



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Nr. 1430/6 Prot

Tiranë, më 17.6.2026

Lënda: Njoftim për ekzekutim vullnetar të gjobës administrative.

SUBJEKTIT “BELLYFULL DELIVERY”, NIPT M41408022I

Adresa: Njësia Administrative Nr.6, Rruga Hamdi Pepo, Pallati MGB, Njësia Tregtare 4B, Kati 0,
Tiranë

TIRANË

Në përfundim të procesit të inspektimit të kryer nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tiranë, *ndaj subjektit “Bellyfull Delivery”, me Nipt M41408022I, është marrë Vendimi Përfundimtar i Inspektimit me Nr.ISHPSHSH-TR-2026-001431-5, datë 10.04.2026, me të cilin është vendosur masa administrative gjobë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë.*

Pas marrjes dijeni të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit, nga ana juaj nuk është ushtruar e drejta e ankimit administrativ pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve të Inspektoratit të Përgjithshëm, brenda afateve ligjore.

Në bazë të nenit 34 të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin në Punë”, i ndryshuar, ekzekutimi i gjobave administrative kryhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Gjithashtu, në nenin 15 të Ligjit për Kundërvajtjet Administrative parashikohet se:

“1. Vendimi për kundërvajtjen administrative nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore nëse ligji i posaçëm parashikon të drejtën e subjektit për t’u ankuar në rrugë administrative, por kjo e drejtë nuk është ushtruar. Për ekzekutimin e tij zbatohen dispozitat e kreut V të këtij ligji.”

Nga sa më sipër, ju njoftojmë se **Vendimi Përfundimtar i Inspektimit Nr.ISHPSHSH-TR-2026-001431-5, datë 10.04.2026, në përputhje me nenet 23 dhe 24 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, është shndërruar në titull ekzekutiv dhe duhet të ekzekutohet në mënyrë vullnetare.**

Në dispozitat e Kreut V të ligjit nr. 10279/2010, konkretisht në nenin 30, pika 1, parashikohet se:

“Gjoha dhe shumata që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data kur është njoftuar për vendimin e dënimit me gjobë, i cili përbën titull ekzekutiv.”


Në këtë kuadër, ju bëjmë me dije se pagesa e gjobës duhet të kryhet **brenda 10 (dhjetë) ditëve**. Bashkëlidhur gjeni **faturën për arkëtimin e gjobës**. Pas kryerjes së pagesës, lutemi të dërgoni **mandatin e arkëtimin** në adresën elektronike: info@slj.gov.al.

Në rast të moskryerjes së pagesës brenda afatit ligjor, **Drejtoria Rajonale Tiranë** do të vijojë me ndjekjen e procedurave për **ekzekutimin e detyrueshëm**, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYEINSPEKTORI

Eljo Muçaj



The image shows a handwritten signature in black ink over a circular official stamp. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E SHqipërisë" at the top, "DREJTORIA RAJONALE TIRANË" around the perimeter, and "INSPEKTORATI RAJONAL" in the center. The signature is written in a cursive style across the stamp.